



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_.10.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 26.10.2023

Nga: “Albpetrol” sha – Patos

Drejtuar: OE “TIRES-R” shpk me NUIS M12413025K, me adresë: Tiranë, Kamëz, Rruga “Iliria”,  
Ndërtesë Private, Zonë Kadastrale Nr.1649, Numër Pasurie 28/26.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-81667-09-28-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje goma auto”

Kohëzgjatja e kontratës është 40 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 82 datë 02 Tetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ANDI HAMO” pf me NUIS K76926201W me vlerë oferte në total 7,401,400 lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “GAJD Company” shpk me NUIS K79631501Q me vlerë oferte në total 6,984,000 lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “SI & CO COMPANY” shpk me NUIS L21420002F me vlerë oferte në total 9,201,000 lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “SPARKLE 32” shpk me NUIS L51327014R me vlerë oferte në total 9,104,000 lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik “TIRES-R” shpk me NUIS M12413025K me vlerë oferte në total 8,975,000 lekë pa TVSH.

\* \* \*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit i mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “ANDI HAMO” pf me NUIS K76926201W për arsyet e mëposhtme:

- *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese për artikujt me numer rendor 1, 3, 11, 12, 13, 20 sipas shtojces 6 tabelës së sasive. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
- *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur certifikaten ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
- *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese për artikujt objekt prokurimi. Në katalogun/skeden teknike të paraqitur, pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet nuk janë në gjuhën shqipe dhe nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.5. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
- *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga OE, nuk janë shënuar emrat e personit (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, për të cilët OE deklaron në këtë fazë që nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës „a“ të pikës 2. ‘Kriteret e veçanta të kualifikimit’ të DST.*
- **Operatori ekonomik “GAJD Company” shpk me NUIS K79631501Q për arsyet e mëposhtme:**
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese për artikujt objekt prokurimi. Në katalogun/skeden teknike të paraqitur, pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet nuk janë në gjuhën shqipe dhe nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.5. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur certifikaten ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës „b“ të pikës 2. ‘Kriteret e veçanta të kualifikimit’ të DST.*
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese për artikujt me numer rendor 1, 3, 11, 12, 13, 20 sipas shtojces 6 tabelës së sasive. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
- **Operatori ekonomik “SI & CO COMPANY” shpk me NUIS L21420002F për arsyet e mëposhtme:**
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40 % vlera e fondit limit. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.1. të pikës 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të DST.*

- *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.1. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese për artikujt me numer rendor 1. 3, 11, 12, 13, 20 sipas shtojces 6 tabelës së sasive. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.4. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
  - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese per artikujt objekt prokurimi. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.5. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*
- Operatori ekonomik “SPARKLE 32” shpk me NUIS L51327014R për arsyet e mëposhtme:
    - *Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese për artikujt me numer rendor 1. 3, 11, 12, 13, 20 sipas shtojces 6 tabelës së sasive. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE, “TIRES-R” shpk me NUIS M12413025K, me adresë: Tiranë, Kamëz, Rruga “Iliria”, Ndërtesë Private, Zonë Kadastrale Nr.1649, Numër Pasurie 28/26, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8,975,000 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

\* \* \*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të “Albpetrol” sha, rruga Fier-Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenet 83 dhe 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Eltar DEDA**